

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Programi - Kurti me premtime të mëdha: 1 mld euro për prodhimin, paga mbi 1 mijë euro
ADRESA	https://www.syri.net/kosova/916499/kurti-me-premtime-te-medha-1-mld-euro-per-prodhimin-p-aga-mbi-1-mije-euro/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 09:10:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 08:44:13 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	21c5f84021f83203ad90b0e2e6b8d8660b8f823b75551d67c3a621ca76f38052
TEKSTI	2ac77114ffc1945db269078f1c7b2e5a02057ae3b0338fd3dc668860ce0a5ab7
PAMJA	765348c117f99d602c5a72f7fb1d6829c3bc6e42177479cc2a1f9ffb9211b85b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d9499a98cf1e2607d241fa2c0191d06d70ceae4456e61a9c139edd0fdc563306
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a9dba7e1cf5e08da052e8f7bcad4dfd2bc0436d1ed5e23cf11abc817a3e1dcfc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d9499a98cf1e2607d241fa2c0191d06d70ceae4456e61a9c139edd0fdc563306>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



ILIR KALEMAJ
Doktra hini dhe bota në tranzicion



ENVER BYTYÇI
Edi Rama edhe në varr nuk ndahet nga Aleksandër Vuçiq!



Kurti me premtime të mëdha: 1 mld euro për prodhimin, paga mbi 1 mijë euro

10:44, 14/09/2026

Kryeministri Albin Kurti ka prezantuar programin e qeverisë së re, me një sërë premtimesh në ekonomi dhe mirëqenie sociale. Ai ka paralajmëruar 1 miliard euro për prodhimin dhe industrinë, deri në 500 milionë euro investime në Brezovicë, 100 milionë euro për investimet e diasporës, dyfishim të shtesave për fëmijët dhe pagë mesatare mbi 1 mijë euro në sektorin publik.

Kryeministri Albin Kurti ka prezantuar në Kuvendin e Kosovës programin qeveritar dhe kabinetin e ri qeverisës, pas votimit të Qeverisë së re të udhëhequr nga ai.

Në fjalimin e tij, Kurti ka deklaruar se qeverisja e re do të fokusohet në zhvillimin ekonomik, prodhimtarinë, mirëqenien sociale, sigurinë, arsimin, shëndetësinë dhe avancimin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës.

Ai ka thënë se nuk do të ketë një ekspozë tërësisht të re, pasi zgjedhjet e përsëritura kanë ndërprerë qeverisjen e njëjtë.

"Vizioni ynë në këto vite të qeverisjes sonë të përbashkët është punë për qytetarin dhe mbrojtje për familjen. Qeveria jonë është shërbim për publikun, jo privilegj për pakicën".

Rritja ekonomike ka qenë mesatarisht 6 për qind

Kurti ka deklaruar se gjatë pesë viteve të fundit Kosova ka shënuar rritje mesatare ekonomike prej 6 për qind, duke theksuar se në çerekun e parë të vitit 2026 rritja ishte 5.4 për qind.

Sipas tij, Bruto Produkti Vendor është rritur nga rreth 7 miliardë euro në 11 miliardë euro, ndërsa për këtë vit është projektuar të arrijë në 12 miliardë euro.

Ai ka thënë se numri i të punësuarve është rritur nga 350 mijë në 430 mijë, ndërsa të ardhurat e familjeve janë rritur përmes pagës minimale, pensione, shtesave për fëmijë dhe pagave në sektorin publik.

Kurti ka paralajmëruar se në mandatin e ri paga mesatare në sektorin publik do të kalojë 1 mijë euro në muaj.

Dyfishim i shtesave për fëmijët

Kryeministri ka bërë të ditur se shtesat për fëmijët do të dyfishohen gjatë mandatit të ardhshëm.

Sipas tij, shtesat do të rriten nga 30 në 60 euro dhe nga 45 në 90 euro për fëmijë.

më të lexuarat

FOTO/ 'Marshi për Liri' mbush sheshet në Prishtinë në prag të verdiktit të Gjykatës Speciale

Haxhiu shtyn për të dielën seancën konstituive mes mosmarrëveshjeve për nënkryetarët

PDK dërgon në Kushtetuese konstituimin e Kuvendit

Kurti me premtime të mëdha: 1 mld euro për prodhimin, paga mbi 1 mijë euro

E rëndë/ Sulmohet dhe kërcënohet kapiteni i Kosovës Amir Rrahmani, denoncohen rastet

Kurti: Emrat për nënkryetarët duhet të sqarohen në takime të përbashkëta

'Politika është larguar nga njerëzit', Andoni: Kanë prishur mitin e zgjedhjeve të lira

varësisht nga numri i fëmijëve në familje.

Ai ka përmendur edhe mbështetjen për nënat lehona, të cilat nga 1 korriku marrin 500 euro në muaj për gjashtë muaj.

Në kuadër të programit "Gjenerata për gjeneratë", Kurti ka propozuar që gjithërit pensionistë që kujdesen për nipërit dhe mbesat nga 13 deri në 36 muaj, në rastet kur të dy prindërit punojnë, të marrin 100 euro shtesë në muaj.

1 miliard euro për prodhimin dhe industrinë

Kurti ka prezantuar një program prej 1 miliard eurosh për prodhimin dhe industrinë.

Ai ka thënë se Banka Zhvillimore do të financojë projektet strategjike, do të mbështesë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe do t'u japë prodhuesve e eksportuesve letërgaranci për pagesa.

Sipas tij, do të lehtësohet marrja e kredive për investitorët që prodhojnë dhe punësojnë, ndërsa përmes amortizimit të përshpejtuar do të ulët kostoja e investimeve.

Kurti ka paralajmëruar edhe faturimin elektronik ndërmjet bizneseve, rimbursim më të shpejtë të TVSH-së dhe heqjen e taksës doganore prej 10 për qind për veturat e importuara nga Bashkimi Evropian.

Ai ka përmendur gjithashtu zhvillimin e Valutës Digjitale të Kosovës, ndërtimin e Kullës TIK në Prishtinë dhe krijimin e 15 qendrave të inovacionit, inkubatorëve teknologjikë dhe industrialë deri në fund të mandatit.

500 milionë euro investime në Brezovicë

Në sektorin e turizmit, Kurti ka prezantuar projektin e madh të Brezovicës, për të cilin ka thënë se do të investohen deri në 500 milionë euro.

Investimet do të përfshijnë rrugët, akomodimin, pistat e skijimit, teleferikët dhe renovimin e ndërtimin e hoteleve.

Ai ka paralajmëruar edhe zhvillimin e Qendrës turistike "Dukagjini" në Pejë, Rugovë dhe Bjeshkët e Nemuna, si dhe mbështetje për bujtinat ekologjike në Bjeshkët e Nemuna dhe në Sharr.

100 milionë euro për investimet e diasporës

Kurti ka deklaruar se përmes "Dritares për Investime të Diasporës" do të mbështeten deri në 100 milionë euro investime të mërgatës në Kosovë.

Shteti, sipas tij, do të jetë garantues i kredive për këto investime.

Ai ka thënë se me anëtarësimin në Zonën e Vetme të Pagesave në Euro (SEPA), mërgimtarëve do t'u kursehen rreth 60 milionë euro nga shpenzimet e dërgesave të parave.

Kryeministri ka paralajmëruar se paga minimale prej 500 eurosh nuk do të tatohet.

Ai ka bërë të ditur se do të ndërmerret nisma për pagën e 13-të në sektorin publik dhe privat, ndërsa në të ardhmen synohet edhe paga e 14-të.

Sipas Kurtit, Fondi i Sigurimeve Shoqërore do të mbështesë punëtorët pas humbjes së vendit të punës dhe do të mbulojë pushimin e lehonisë dhe pushimin prindëror.

Investime në arsim dhe shëndetësi

Kurti ka paralajmëruar dyfishimin e buxhetit për bursa studentore dhe zgjerimin e mbështetjes edhe për studentët e kolegjeve jopublike.

Ai ka thënë se do të hapen pesë gjimnaze të specializuara, do të shtohen dhjetë profile të reja në arsimin dual dhe interneti i shpejtë e falas do të shtrihet në 1 mijë institucione parauniversitare.

Në shëndetësi, ai ka deklaruar se çdo qytetar do ta ketë mjekun familjar dhe do të përfshihet në regjistrin e kujdesit parësor.

Kurti ka paralajmëruar ndërtimin e spitaleve të reja në Mitrovicë dhe Ferizaj, pajisjen e spitaleve publike me tomografi të kompjuterizuar dhe rritjen e buxhetit për listën esenciale të barnave deri në 100 milionë euro.

Mbi 1 miliard euro për ushtrinë

Në fushën e mbrojtjes, Kurti ka bërë të ditur se për Forcën e Sigurisë së Kosovës do të ndahen mbi 1 miliard euro gjatë katër viteve të ardhshme.

Vazhdimi i seancës konstituive sot nga ora 10:00, ky është rendi i ditës

Gjykata e Apelit liron nga akuzat Çekun dhe 9 të dënuarit e tjerë në rastin 'Veteranët'

Ai ka deklaruar se industria ushtarake "Made in Kosova" do të fokusohet në prodhimin e municionit, dronëve, robotëve dhe teknologjive të tjera mbrojtëse.

Sipas tij, prodhimi i municionit është paraparë të nisë brenda vitit 2026.

Kurti ka paralajmëruar edhe krijimin e Njësisë Ushtarake të Përbashkët me Shqipërinë, si dhe rritjen e numrit të grave dhe vajzave në FSK në 1 mijë.

Në fushën e sigurisë, Kurti ka deklaruar se do të themelohet Xhandarmëria e Republikës së Kosovës.

Sipas tij, kjo njësi do të ketë për detyrë mbrojtjen e kufirit, luftimin e terrorizmit, përballimin e rreziqeve të larta dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike.

Ai ka paralajmëruar edhe fuqizimin e njësisë të dronëve dhe antidronëve, si dhe pajisjen e Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit me teknologji të avancuara.

Investime në energji dhe infrastrukturë

Kurti ka deklaruar se do të modernizohen termocentralet Kosova A dhe Kosova B, ndërsa synohet sigurimi i 305 megavatëve nga era dhe 250 megavatëve nga dielli.

Ai ka thënë se synimi është që 20 për qind e energjisë së konsumuar të vijë nga burimet e pastra.

Në infrastrukturë, kryeministri ka paralajmëruar ndërtimin e hekurudhës Gjakovë–Shkodër, në kuadër të lidhjes hekurudhore Prishtinë–Durrës, si dhe projekte të tjera rrugore, përfshirë autostradën e Gjilanit deri te Dheu i Bardhë dhe rrugën Prizren–Tetovë.

Sipas tij, investimet kapitale do të synojnë të kalojnë 1 miliard euro në vit.

Kurti ka deklaruar se Qeveria do të vazhdojë përkujdesjen për kategoritë e dala nga lufta dhe familjet e dëshmorëve.

Ai ka thënë se familjet me një dëshmor tash marrin 537 euro pension, ndërsa familjet me dy dëshmorë 806 euro.

Kryeministri ka kërkuar gjithashtu nga Serbia hapjen e arkivave që lidhen me krimet e luftës në Kosovë dhe ka thënë se zbardhja e fatit të personave të zhdukur me dhunë do të mbetet detyrë shtetërore.

Në fillim të fjalimit, Kurti ka folur edhe për procesin gjyqësor ndaj ish-krerëve të UÇK-së në Hagë.

Ai ka thënë se kërkesa e Prokurorisë është e padrejtë dhe në shpërputhje me të vërtetën historike të popullit shqiptar.

"Qëndrimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës që unë e drejtoj është i njëjtë dhe i qartë: në Kosovë janë kryer krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe gjenocid ndaj popullatës civile shqiptare. Ato i ka kryer regjimi i Jugosllavisë së Serbisë, nën Millosheviqin. Asnjë gjykatë vendore apo ndërkombëtare nuk mund ta njollojë UÇK-në".

Kabineti i ri qeveritar

Në fund të fjalimit, Kurti ka prezantuar kabinetin e ri qeveritar, i cili përbëhet nga:

Zëvendëskryeministër i parë dhe ministër i Punëve të Jashtme dhe Diasporës:

Glauk Konjufca

Zëvendëskryeministër e dytë dhe ministër e Drejtësisë: Donika Gërvalla

Zëvendëskryeministër i tretë për Çështje të Pakicave dhe Bashkëpunim: Fikrim Damka

Ministër i Financave: Hekuran Murati

Ministër për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare: Andin Hoti

Ministër i Mbrojtjes: Ejup Maqedonci

Ministër i Punëve të Brendshme: Xhelal Sveçla

Ministër i Digjitalizimit dhe Administratës Publike: Lulëzon Jagxhiu

Ministër i Shëndetësisë: Arben Vitia

Ministër i Arsimit dhe Shkencës: Hajrullah Çeku

Ministër e Kulturës dhe Turizmit: Saranda Bogujevci

Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal: Elbert Krasniqi

Ministër i Sportit dhe Rinisë: Blerim Gashani

Ministër e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor: Fitore Pacolli

Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural: Armend Muja

Ministër i Infrastrukturës dhe Transportit: Dimal Basha

Ministër e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit: Mimoza Kusari

Ministër e Ekonomisë: Artane Rizvanolli

Ministër për Komunitete dhe Kulturë, Vendi Rasim
Ministër për Zhvillim Rajonal: Rasim Demiri

Kurti ka thënë se Qeveria e re ka program të qartë, masa të përcaktuara dhe përgjegjësi të matshme.

Ai ka bërë të ditur se në tetor do të prezantohet Buxheti i Kosovës për vitin 2027, ndërsa ka kërkuar nga Kuvendi mbështetje për zbatimin e programit qeveritar dhe zgjedhjen e Presidentit të Republikës.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Kurti thirrje liderëve politikë: Ta zgjidhim çështjen e presidentit



PDK dërgon në Kushtetuese konstituimin e Kuvendit



Sot mbahet mbledhja e parë e Qeverisë së re

Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

TË NGJASHME



Programi i Kurtit: Mbi 1 miliard euro për ushtrinë, pagë mesatare 1 mijë euro në muaj e dyfishim të shtesave për fëmijët



Kosova bëhet me qeveri të re, REL: Çfarë ndodh tani?



Haxhiu: Kosova ka nevojë për institucione të forta e funksionale, jo pritje e vonesa të reja



VIDEO/ Simnica: Diaspora shqiptare duhet ta ngrejë zërin për Kosovën, vendin e kemi në familjen evropiane



Opozita bojkotoi/ Me 62 vota pro dhe 8 kundër, zgjidhet qeveria e re e Kosovës, betohet në Kuvend



U mandatua për krijimin e qeverisë së re, Albin Kurti prezanton emrat për kabinetin e ri

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MËDIË ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net